



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, sipas autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 3, paragrafi 4 të Rregullës së KQZ nr. 01/2023 mbi Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike, me datë 06.12.2023 duke votuar me procedurën qarkulluese merr këtë:

V E N D I M

Për regjistrimin e partisë politike Srpska Demokratija-SD

- I. Regjistrohet partia politike “Srpska Demokratija” me akronim SD, me Kryetar z. Aleksandar Arsenijević.
- II. Partia politike Srpska Demokratija, i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe obligimet e përcaktuara me nenin 2 të Rregullës 01/2023 Për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike.
- III. Partia politike Srpska Demokratija, obligohet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin në bazë nenit 12 të Rregullës 01/2023 Për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike.
- IV. Obligohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike që të përgatisë certifikatën e regjistrimit dhe ta regjistrojë partinë politike Srpska Demokratija në Regjistrin e Partive Politike të Kosovës.
- V. Obligohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike që ta njoftoj partinë politike Srpska Demokratija, për marrjen e këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Prishtinë, 06.12.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi